

16.02.2022  
Ora 18:06

**RENDI I DITËS**

Projektvendim “Për rregullat procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale, nga vendet e numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjeshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”.

**PJESËMARRJA :**

**KQZ:**

- Ilirjan            **CELIBASHI**            **Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- Komisioni Rregullator:
- Ilirjana            **NANO**                            **Kryetar**
- Arens              **ÇELA**                            **Anëtar**
- Dritan             **ÇAKA**                          **Anëtar**
- Helga              **VUKAJ**                        **Anëtar**
- Muharrem        **ÇAKAJ**                        **Anëtar**
- Stafi                **KQZ**                            **Y.Merkaj,**

**Znj. I. Nano:** Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Mbledhja filloi me një vonesë të shkurtër. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Sekretari i Përgjithshëm i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një projektvendim të rëndësishëm, ai “Për miratimin e rregullave procedurale për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve (ekraneve)

Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2022*

në vendet e numërimit të votave dhe transmetimin në kohë reale nga vendet e numërimit të votave në ambientet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e pjesshme për kryetar bashkie, të datës 6 Mars 2022”. Ky projektvendim vjen sot për shqyrtim në Komisionin Rregullator me propozim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Gjithashtu vjen pas miratimit të disa ditëve më herët, të një vendimi tjetër të Komisionit Rregullator, për përdorimin e kamerave regjistruese dhe monitorëve (ekraneve) në vendet e numërimit të votave. Paraprakisht më lejoni të pyes anëtarët e Komisionit Rregullator nëse kanë ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për diskutim, kolegë? Nuk ka! Atëherë vijojmë me rendin e ditës. Do t’i lutesha zotit Merkaj, Sekretarit të Përgjithshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të prezantonte në mënyrë të përmbledhur projektaktin.

**Z. Y. Merkaj:** Presidenti i Republikës ka dekretuar datën 6 mars 2022 për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnje. Neni 22, pika 2 e Kodit Zgjedhor përcakton se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kompetencë të instalojë dhe përdorë sisteme video-monitorimi në qendrat e votimit, si dhe kur bëhet numërim manual i votave në vendin e numërimit të votave për të monitoruar dhe provuar rregullshmërinë e procesit në mjediset e brendshme të tyre. Përdorimi i sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit bëhet në përputhje me rregullat e posaçme lidhur me procedurat dhe aspektet e veçanta të procesit, që mbulojnë nga sistemet apo nga pajisjet e teknologjisë së informacionit. Rregullat proceduriale për këtë qëllim miratohen me akt normativ të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Referuar nenit 12, pika 4 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator është organi kompetent për miratimin e akteve me karakter normativ në fushën e zgjedhjeve dhe vendosjen e rregullave për zgjedhjet. Në referim të neneve të mësipërme, Komisioni Qendror i

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2022*

Zgjedhjeve do të realizojë implementimin e kamerave regjistruese në çdo tavolinë numërimi, në vendin e numërimit të votave. Regjistrimet filmike të video-procesit të numërimit të votave nga kamerat e tavolinat dhe kamerat e vrojtimit në vendet e numërimit të votave, do të ruhen në pajisjet elektronike të sigurta dhe do të dorëzohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve së bashku me materialet e tjera zgjedhore. Administrata e KQZ-së, ose kur është e mundur dhe KZAZ-ja do të riprodhojë kopjet materiale të regjistruara dhe t'i vërë në dispozicion të subjekteve zgjedhore nëse i kërkojnë sipas tarifave të përcaktuara. Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat në VNV, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, do të jetë deri në përfundim të verifikimit paszgjedhor të sistemeve, apo pajisjeve të teknologjisë së informacionit, ose deri në hapjen e kutive të votimit. Pas mbarimit të afatit, materiali filmik ruhet në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 për arkivat. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Merkaj! Fillojmë me shqyrtimin në parim të projektvendimit. Kolegë, lidhur me projektvendimin në parim, keni diçka për të diskutuar? Nëse jo, kalojmë në votimin në parim të projektvendimit.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet në parim projektvendimi!

Kalojmë në shqyrtimin nen për nen. Paraprakisht do të thoja që projektvendimi përmban 6 pika dhe dy lidhje me karakter teknik. Lidhja e parë që ka rregullat proceduriale për përdorimin e kamerave, ka 13 pika. Lidhja e dytë, në përmbajtje ka koston e shërbimit administrativ të këqyrjes dhe vlerën financiare të video-regjistrimit. Kështu që, për hir të praktikës së vendosur tashmë, unë në kushtet e një akti voluminoz, nuk po lexoj nen për nen, por do kalojmë në

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2022*

shqyrtimin e secilit nen, përkatësisht të secilës pikë dhe nëse kolegët kanë pyetje për administratën, kërkesë për sqarime, apo propozime për shtesa dhe ndryshime, janë të lutur ta bëjnë hap pas hapi në secilën pikë. Fillojmë me pikën 1. Kolegë? Nuk ka pyetje apo propozime! Votojmë pikën 1.

***Kush është dakord?***

***Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

***Kundra:** S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 2. Regjistrimi filmik dhe ruajtja e tij. Nuk kemi diskutime! Kalojmë në votimin e pikës 2.

***Kush është dakord?***

***Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)*

***Kundra:** S'ka*

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në pikën 3, te riprodhimi i kopjeve të materialit të regjistruar. Zoti Çaka, po!

***Z. D. Çaka:*** Faleminderit zonja kryetare! Atëherë duke pasur parasysh edhe projektvendimin, por njëkohësisht dhe eksperincën që kemi pasur në zgjedhjet e kaluara, doja që të bëja një, mund ta konsiderojmë një sugjerim. Tek pika 3 e vendimit, aty ku thuhet “administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ose ku është e mundur ZAZ-ja” besoj që ky duhet të jetë një gabim, dhe duhet të jetë “KZAZ-ja dhe komisioni” dhe duke qenë se kjo pikë i referohet lidhjes nr. 2, është cituar që përsa i përket kostos së shërbimit administrativ, këtu është cituar që vlera financiare për shërbimin do të jetë 500 lekë. Ndërkohë duke pasur parasysh edhe vetë përmbajtjen e aktit, por njëkohësisht dhe atij pararendës, thuhet që “kostoja e shërbimit administrativ të këqyrjes do jetë në varësi të orëve”. Kështu që besoj që kjo vlerë 500 lekë duhet të jetë për orë dhe

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



jo për totalin e shërbimit që do të ofrojë KQZ-ja. Kështu që unë dhe në qoftë se kolegët janë dakord, mbase mund të mos e konsiderojmë...

**Znj. I. Nano:** Është një korrigjim. Besoj zoti Merkaj është...

**Z. Y. Merkaj:** Po, duhet të jetë një korrigjim, është lapsus.

**Znj. I. Nano:** Është korrigjim, është lapsus, pra nuk ka nevojë për një propozim dhe për votimin e propozimit. Kolegë? Atëherë, nëse nuk ka diçka tjetër përveç këtyre korrigjimeve të vogla që administrata do t'i ketë parasysh gjatë zbardhjes. Kalojmë në votimin e pikës 3.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë tek pika 4. Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar. Kolegë, kemi diçka për të diskutuar? Po, Zonja Vukaj?

**Znj. H. Vukaj:** Një moment sqarimi kam dhe do doja të dija për këtë sqarim ose për këtë lidhëz që ma bën të dyshimtë pak paragrafin. Nga administrata, ose çfarë ka pasur parasysh me vendosjen e dy kufizimeve për afatin e ruajtjes së materialit të regjistruar, ku thuhet "të jetë afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat e VNV-së, në KQZ, të jetë deri në përfundimin e verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo pajisjeve të teknologjisë dhe informacionit, ose deri në hapjen e kutive"?

**Z. Y. Merkaj:** Atëherë, ideja është, kemi pasur parasysh nenin 167/2 të Kodit Zgjedhor dhe 178 të Kodit Zgjedhor, i cili thotë, neni 78 thotë "6 muaj pas

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2022*

shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, KQZ-ja hap të gjitha kutitë e votimit, procesverbalet e votimit, tabelat dhe procesverbalet e numrit të fletëve të votimit, dokumentacionin që ndodhet në kutinë e materialeve dhe ia dërgon arkivit qendror”. Ideja është që ne ta bëjmë hapjen ose këqyrjen paszgjedhore përpara se të kalojnë 6 muaj, prandaj kemi vënë dy kufizimet. Domethënë do të jetë këqyrja paszgjedhore, e cila është menjëherë pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, bëhet këqyrja paszgjedhore dhe kjo duhet të jetë ose pas shpalljes së rezultatit përfundimtar, ose brenda 6 muajve nga momenti i shpalljes së rezultatit përfundimtar, prandaj e kemi shkruar.

**Znj. H. Vukaj:** E qartë, por lidhëza “ose deri në hapjen e kutive” duket sikur e lë pak evazive mundësinë e hapjes së kutive. Pra, i jep predispozicionin këtij material që të ketë si kohë primare atë të përfundimit të verifikimit paszgjedhor të sistemeve apo të pajisjeve të teknologjisë.

**Z. Y. Merkaj:** Ndoshta është shprehur gabim! Duhet shkruar “deri në hapjen e kutive” ose deri në 6 muaj. Nuk duhet lidhëza “ose”.

**Znj. H. Vukaj:** Lidhëza “ose deri në hapjen e kutive” duhet të bjerë them unë

**Z. Y. Merkaj:** Duhet të bjerë, po!

**Znj. H. Vukaj:** Dhe do të mbetet “si edhe deri në hapjen e kutive”, nëse kolegët janë dakord? Sepse janë dy momente që kushtëzojnë, por janë të pavarura nga njëra-tjetra. Pra, dy procese aposteriori të verifikimit, të cilat janë të pavarura nga njëra-tjetra, por që duhen respektuar që të dyja. Kështu që mendoj që ka rënë në përsëritje lidhëza “ose”, ose ka zhvleftësuar në thonjëza disi procesin e

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.16.02.2022*

dytë, mundësinë e dytë të verifikimit, dhe aty do ishte më adekuate të shtohet “si edhe”.

**Znj. I. Nano:** Vlerësoni një riformulim për të përcaktuar afatin maksimal. Afati maksimal lidhet me procesin që kryhet në radhë të dytë.

**Z. Y. Merkaj:** Për hapjen e kutive.

**Z. D. Çaka:** Një pyetje për administratën. Kur këtu keni dashur të shprehni procesin e hapjes së kutive, në cilin moment keni menduar këtë proces?

**Z. Y. Merkaj:** Procesi i hapjes së kutive parashikohet nga neni 178, pika 6 e Kodit Zgjedhor, që thotë “6 muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar”. Pra, domethënë kjo është pika e hapjes së kutive, që ta thjeshtonim si dispozitë, si nen, e shkruam hapjen e kutive të votimit.


**Znj. I. Nano:** 178/6, 6 muaj pas shpalljes së rezultatit përfundimtar KQZ hap gjithë kutitë e votimit, nxjerr procesverbalet e votimit, tabelat dhe procesverbalet e numrit të fletëve votimit, dokumentacionin që ndodhet në kutitë e materialeve të votimit dhe ia dërgon ato Arkivit Qendror të Shtetit, në mënyrën e caktuar prej tij.

**Z. Y. Merkaj:** Që këtu asgjësohen të gjitha fletët e votimit. Duke asgjësuar fletët e votimit...

**Znj. I. Nano:** 6 muaj mbas shpalljes së rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

**Z. Y. Merkaj:** Ne nuk duam që në qoftë se asgjësojmë fletët e votimit, nuk ka më kuptim që ta mbajmë materialin në..

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Znj. I. Nano:** Pra, edhe materiali filmik në përfundim të këtij procesi të dërgohet sikundër është parashikuar, të ruhet në përputhje me ligjin për arkivat. Verifikimi paszgjedhor i sistemeve për kujtesë, zoti Merkaj,

**Z. Y. Merkaj:** Flet përpara hapjes së kutive. Bëhet përpara hapjes së kutive.


**Znj. I. Nano:** Atëherë ka kuptim që t'i kemi të dyja këto procese, të cilat ndodhin në afate të ndryshme, apo të lëmë afatin maksimal deri në hapjen e kutive? Pra, janë dy procese që ndodhin në dy kohë të ndryshme. Më herët ndodh verifikimi paszgjedhor, më vonë ndodh hapja e kutive sipas 178-ës. Që do të thotë, materiali i regjistruar qëndron në afatin maksimal dhe pastaj ruhet sipas ligjit për arkivat. Nuk e di kolegë, nisur nga shqetësimi i paraqitur nga zonja Vukaj dhe mbas këtij diskutimi, një vlerësim tuajin, a ta lëmë afatin e ruajtjes deri në afatin maksimal, pra deri kur ndodh procesi i mëvonshëm që është hapja e kutive?

**Znj. H. Vukaj:** Shumë i drejtë ky sugjerim, por ndoshta draftuesit kanë pasur parasysh edhe facilitetin e leximit të këtij rregulli nga të tretët. Domethënë, ta kenë si pasqyrë informative dhe transparence, që afati i procesit të parë dhe më pas afati maksimal i procesit të dytë. Thjesht nuk impakton, por thjesht qartëson në këtë formë dhe e zgjidh ajo lidhëza “si edhe”, mendoj.

**Znj. I. Nano:** Atëherë, zoti Merkaj edhe njëherë ju lutem! Nëse ju si administratë do ta riformulonit edhe njëherë këtë, si do të ishte?

**Z. Y. Merkaj:** Mund ta bëjmë shkurt, më thjesht. “Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat e vendet e numërimit të votave në KQZ të jetë deri në hapjen e kutive të votimit”, ndoshta mund të jetë dhe kjo shumë e shkurtër.

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*





**Znj. I. Nano:** Dhe ne mund të bëjmë referencën tek neni 178?

**Z. Y. Merkaj:** Po, 178!

**Znj. I. Nano:** Në rregull, në qoftë se do duam t'i përfshijmë të dy proceset, janë njëra pas tjetrës, janë si procese që ndodhin në kohë të ndryshme.

**Z. Y. Merkaj:** Këqyrja paszgjedhore është neni 167, pika 2, që thotë “Këqyrja lejohet të bëhet vetëm pasi të jetë shpallur rezultati përfundimtar dhe të jetë përmbyllur procedura ankimore”. Ky është afati që parashikon Kodi dhe ne në këtë moment do ta hapim, të bëjmë këqyrjen paszgjedhore.

**Znj. I. Nano:** Atëherë kolegë, duke pasur parasysh sqarimet e administratës, duke qenë që procesi më i fundmë është hapja e kutive, përtej këtij afati nuk ka kuptim ruajtja e materialit të regjistruar nga kamerat në KQZ. Pra, përtej këtij afati ruajtja bëhet sipas ligjit për arkivat. Ta bëj një propozim për riformulimin e pikës 4, “Afati i ruajtjes së materialit të regjistruar nga kamerat e VNV-së në KQZ të jetë deri në përfundim të procesit të hapjes së kutive sipas nenit 178, pika 6”. E kemi referencën konkrete, të Kodit Zgjedhor? Votojmë këtë propozim? Vetëm riformulimi i fjalisë së parë?

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet propozimi!

Atëherë votojmë pikën 4 në tërësi.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*



**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Pika 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

**Kush është dakord?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Dukë qenë që projektvendimin e kemi votuar në parim dhe nen për nen. Kalojmë në votimin në tërësi të tij, edhe njëherë kolegë.

**Kush është dakord në tërësi me projektvendimin pas ndryshimeve dhe sugjerimeve?**

**Pro:** 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

**Kundra:** S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Në rendin e ditës nuk kemi çështje tjetër për diskutim, gjithashtu as çështje jashtë rendit të ditës. Me miratimin e vendimit, e shpall mbledhjen të mbyllur, faleminderit!

**Vendimi nr. 19**

*Zbardhi materialin audio  
Lorena KONJA*

